



## Breaking News:



Lajmet Operacionet

# Tiranë/Finalizohet Operacioni Policor I Koduar “Village”

04/09/2025

Tiranë/Finalizohet operacioni policor i koduar "Village".

Lëvizte i armatosur me pistoletë, kapet dhe vihet në pranga 22-vjeçari.

Sekuestrohet arma e zjarrit dhe municion luftarak.

Në vijim të operacioneve policore, me objektiv identifikimin e shtetasve që lëvizin të armatosur dhe janë rrezik për qytetarët dhe sigurinë publike, Komisariati i Policisë Nr. 1 finalizoi si rezultat i administrimit të shpejtë të informacionit të siguruar në rrugë operative, operacionin "Village".

Gjatë operacionit, u kap në fshatin Krrabë, ku ishte banues, shtetasi R. Rr., 22 vjeç.

Gjatë kontrollit në çantë, iu gjet 1 armë zjarri pistoletë me municion, të cilët e mbante pa leje. Sapo ka parë shërbimet e Policisë, 22-vjeçari ka tentuar të largohet, por si rezultat i veprimeve të shpejta operacionale, është mundur kapja dhe vënja e tij në pranga.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



# Komisariati Dixhital



Download on the  
**App Store**

Arkiva

Select Month

Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent

◀ Gjirokastër/Kreu parakalim të rrezikshëm, gjobitet drejtuesi i kamionit

Tiranë/Finalizohet operacioni policor i koduar "Bilanci" ►